STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 3 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON MBI 27 MILION DOLLARË NË GRANTE FEDERALE PËR TË PUNËSUAR PUNËTORË PËR PASTRIMIN E KOMUNITETEVE TË PREKURA NGA URAGANI SANDY

Grantet do të jepen për njujorkezët të cilët kanë humbur punën për shkak të uraganit Sandy

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se shteti i Nju Jorkut ka marrë 27.792.296 dollarë fonde federale nga Granti Kombëtar Emergjent në Rast Fatkeqësie Natyrore (Disaster National Emergency Grant) (NEG). Granti do të përdoret për të punësuar punonjësit që kanë humbur punën si rezultat direkt i uraganit Sandy në komunat Bronx, Kings, New York, Richmond, Queens, Nassau, Suffolk, Rockland dhe Westchester për të ndihmuar në pastrimin e komuniteteve të prekura.

"Ky grant federal do të sigurojë fonde për të punësuar punonjës të tjerë të cilët nevojiten shumë për të pastruar dhe normalizuar situatën në komunitetet e prekura nga uragani Sandy dhe për të rikthyer në punë njujorkezët", tha guvernatori Cuomo. "Unë falënderoj sekretaren e punës Hilda Solis për reagimin e saj të shpejtë për dhënien e ndihmës shtetit tonë".

Për të përfituar, punonjësit duhet të kenë humbur punën si rezultat i uraganit Sandy ose të jenë të papunë dhe nuk marrin përfitime papunësie ose ndihmë tjetër financiare.

Punonjësit e interesuar në këtë program duhet të telefonojnë në 1-888-4-NYSDOL (1-888-469-7365). Departamenti i Punës i shtetit të Nju Jorkut do të punojë me zyrtarët vendorë për të rekrutuar dhe punësuar punëtorët.

Informacioni gjendet gjithashtu në qendrat vendore për rimëkëmbjen nga fatkeqësia natyrore (Disaster Recovery Centers) dhe ato të karrierës (One-Stop Career Centers). Një listë e One-Stop Career Centers mund të gjendet në uebsitin e Departamentit të Punës të Shtetit në http://www.labor.ny.gov/workforcenypartners/osview.asp.

Komunat që përfitojnë nga ndihma për pastrimin sipas këtij granti janë ato të mbuluara nga Deklarata e Fatkeqësisë për Ndihmë Publike të Agjencisë Federale për Menaxhimin e Emergjencave (Federal Emergency Management Agency (FEMA) Disaster Declaration for Public Assistance). Ato përfshijnë komunat e Bronx, Kings, Neë York, Richmond, Queens, Nassau, Suffolk, Rockland dhe Ëestchester counties.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian